



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit nr. 04/L-110 të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 dhe nenit 24, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurë për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës për leje përdorimi 05nr.391/02-0035854/18 dt.12.02.2018, të pronarit dhe investitorit Zeqir Haxhija nga fshati Korenicë-Gjakovë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative me date 01.03.2018 merr këtë:

V E N D I M C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

- I. I LEJOHET pronarit dhe investitorit Zeqir Haxhija nga fshati Korenicë-Gjakovë, përdorimi i ndërtesës afariste & banesore me, etazhitet B+S+P+6, e ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-1384 dt.05.04.2011, në kuadër të bllokut urban "C2" të Planit Rregullues "Kalabria" në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1861-1 ZK Prishtinë), të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, si dhe Miratuar me Vendim 05nr.035-67572 dt.11.12.2017 për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës afariste në hapësirë të banimit, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.
- II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi e ndërtuar në rrugën "Sylejman Vuçitërrna", Hyrja, 45, 47, 49, 51 dhe 53 në Prishtinë, do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III. Ky Vendim do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.
- VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumentacioni ndërtimorë i përberë nga atestet e materialeve; certifikatat, etj.

A r s y e t i m

Pronari dhe investitori Zeqir Haxhija nga fshati Korenicë-Gjakovë, me kërkesën me 05nr.391/02-0035854/18 dt.12.02.2018, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për dhënjen e lejes së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, me etazhitet B+S+P+6, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "C2" të Planit Rregullues "Kalabria" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1861-1 ZK Prishtinë, ndërtuar sipas Aktvendimit të Lejes Ndërtimore 05nr.351-1384 dt.05.04.2011 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit

dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës dhe si dhe Miratuar me Vendim 05nr.035-67572 dt.11.12.2017 për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës afariste në hapësirë të banimit, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar: Procesverbalin e datës 12.02.2016 mbi kontrollimin teknik të objektit investuese nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtori sipas Vendimit 05nr.35-45552, dt.10.12.2014; Kopjen e planit të parcelës kadastrale nr. 1861-1 ZK Prishtinë); Certifikaten e njësis kadastrale nr. P-71914059-01861-1 ZK Prishtinë; Lejen Urbanistike 05nr.350-699, dt.08.02.2008; Aktvendimit e lejes ndërtimore 05nr.351-1384 dt.05.04.2011; Aktvendimin e kompenzimit 05nr.351-1384, dt.11.03.2011; Vendimin e Miratimit për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës afariste në hapësirë të banimit 05nr.391-103617/1 dt.23.01.2018; Aktvendimin e kompenzimit për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirës afariste në hapësirë të banimit 05nr.356-67572 dt.11.12.2017; Incizimin gjeodezik; Atestet e materialeve; Certifikatat, etj.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të provave të lëndës 05nr.391/02-0035854/18 dt.12.02.2018, konkretisht "Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit shumëbanesor-objekti B në bllokun "C-2" Kalabri, Prishtinë" i datës 12.02.2016, me procesverbalet e anëtareve të komisionit për kontrollim teknik, dhe hulumtimin e dosjeve të lëndës në arkivin e drejtorisë për ndërtesën në fjalë, konstatoi se:

Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, bazuar në kërkesën për leje ndërtimi 05nr.351-1384 dt.31.01.2011, të pronarit dhe investitorit të lartcekur, me Aktvendim 05nr.351-1384 dt.05.04.2011, ka lejuar ndërtimin e ndërtesës së lartcekur.

Pas përfundimit të punimeve bazuar në kërkesën e investitorit Zeqir Haxhija fshati Korenicë-Gjakovë, kjo drejtori me Vendimin 05nr.35-45552, dt.10.12.2012, ka caktuar komisionin për pranimit teknik të ndërtesës afariste & banesore me etazhitet B+S+P+6.

Komisioni i pranimit teknik, pas pranimit të vendimit të lartcekur, verifikimit të dokumentacionit dhe vizitave në teren me procesverbalin e datës 12.02.2016 ka përpiluar "Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit shumëbanesor-objekti B në bllokun "C-2" Kalabri, Prishtinë", me raportin përfundimtar për të gjeturat nga dokumentacioni dhe vizitat në teren. Sipas raporteve të secilit anëtar të komisionit, konstatohet se: ndërtesa pranohet teknikisht por për ndryshimet e realizuara nga projekti kryesor në atë zbatues të kërkojë nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pëlqimin për plotësimin dhe ndryshimin e Lejes Ndërtimore. Pas miratimit të ndryshimit të realizuara sipas projektit ekzistues mund të vazhdohet me procedurën për paisje me leje të shfrytëzimit dhe përdorimit të objektit.

Duke u bazuar në raportin përfundimtar të komisionit për pranimit teknik të datës 12.02.2016, përkatësisht në konkludimin përfundimtar, investitori Zeqir Haxhija nga fshati Korenicë-Gjakovë, ka kërkuar nga kjo drejtori ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave garazhuese në hapësira afariste dhe të hapësirave afariste në hapësira banimore me kërkesën 05nr.035-67572, dt.22.03.2016, dhe e njëjta ka miratuar ndryshimet me Vendimin 05nr.035-67572, dt.11.12.2017.

Bazuar në konstatimet e lart shënuara, dokumentacionit të prezantuar, rregullatives ligjore në fuqi, konkretisht neni 27 të Ligjit për Ndërtim nr. 04/L-110 të datës 31.05.2012, mund të konstatohet se janë plotësuar kushtet për lëshimin e certifikatës së përdorimit, andaj edhe u vendos si në piken I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendimi mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësim nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet të organi epror-MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkesit, Drejtorisë së Kadastrit, Qendrës për shërbim me qytetar, kësaj Drejtorie dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02 - 0035854/18 DT. 01.03.2018**

Punoi:
Bahtije Vllasaliu
B. VLLASALIU

Kontrolloi:
Nazife Krasniqi



DREJTOR:
Ardian Olluri

